MAL BERISHA

NJË PENG NDERI PËR KONGRESMENIN AMERIKAN ELIOT ENGEL DHE AKTIVISTIN E ÇËSHTJES KOMBËTARE, Z. HARRY BAJRAKTARI

MAL BERISHA

NJË PENG NDERI PËR KONGRESMENIN AMERIKAN ELIOT ENGEL DHE AKTIVISTIN E ÇËSHTJES KOMBËTARE, Z. HARRY BAJRAKTARI



RANKING MEMBER
COMMITTEE ON
FOREIGN AFFAIRS

COMMITTEE ON
ENERGY AND COMMERCE

HEALTH SUBCOMMITTEE

ENERGY AND POWER SUBCOMMITTEE

ASSISTANT DEMOCRATIC WHIP

WEBSITE: http://engel.house.gov

FACEBOOK:
http://www.facebook.com/RepEliotEngel

TWITTER: @RepEliotEngel

Congress of the United States
House of Representatives
Eliot L. Engel
16th District, Ohio Bank

DISTRICT OFFICES:

September 12, 2016

The Honorable Mal Berisha
Tirana, Albania

Dear Ambassador Berisha:

It was great seeing you in Albania recently.

I had a productive and enjoyable visit and appreciate your efforts to arrange the event in Lezhe.
I will treasure my honorary citizenship and the fond memories of that special day.

Thanks again for making it all possible.

Sincerely,

Eliot L. Engel

ELIOT L. ENGEL
Ranking Member
House Foreign Affairs Committee

Episodi i pare

FALENDERIM KONGRESMENIT ELIOT ENGEL DHE AKTIVISTIT HARRY BAJRAKTARI

Nga data 31 gusht deri më 2 shtator 2016, Kongresmeni i njohur amerikan, mik i dashur i shqiptarëve, i shoqëruar nga aktivisti i shquar i çështjes shqiptare z Harry Bajraktari, bënë një vizitë në Shqipëri. Gjatë atyre ditëve pata nderin dhe mundësinë e rrallë të merresha me organizimin e vizitës së tyre në Bashkinë e Lezhës e cila iu akordoi atyre titujt: "Qytetar Nderi" për kongresmenin Engel, dhe "Mirënjohja e Bashkisë së Lezhës" për z Bajraktari.
Kryetari i Bashkisë, Këshilli Bashkiak dhe Kryetari i Këshillit Bashkiak u treguan shumë bujarë, jo vetëm me titujt që iu akorduan mysafirëve të nderuar, por edhe me simbolikën që mbarti kjo veprimtari, e organizuar në mjediset e Memorialit të Heroit tonë Kombëtar, **Skënderbeut**, në Lezhë.
Fjalët e ndjera, të thëna me zemër nga të dyja palët, veprimtaria kulturore-artistike, panorama historike e qytetit e

dhënë me mjeshtëri në gjuhën angleze nga **drejtoresha e bibliotekës së qytetit**, ballada e **Gjergj Fishtës**, interpretuar nga sopranoja e qytetit, si dhe dekori historik, e bënë këtë veprimtari edhe më të bukur dhe më domethënëse.

Ashtu siç ndodh në një shtet serioz si **ShBA-ja**, pas kthimit në atdhe, mysafirët dërguan letra falënderimi.

Dy letrat që mora janë si dy gurë të çmuar në memorien time për atë ditë të mrekullueshme.

Mirënjohje për mysafirët, për nderin që na bënë.

Mirënjohje për Kryetarin e Bashkisë, z. **Fran Frrokaj**, dhe nënkryetaren, znj. **Alfrida Dedgjonaj**, si dhe për artistët lezhjanë, të cilët e zbukuruan aq shumë atë ditë dhe nderuan jo vetëm qytetin e tyre të bukur, por mbarë Shqipërinë.

Episodi i dytë

NJË PENG NDERI PËR KONGRESMENIN AMERIKAN ELIOT ENGEL

Hyrje

Këto ditë, pas një karriere 32-vjeçare si anëtar i Dhomës së Përfaqësuesve në Kongresin Amerikan, miku i shtrenjtë i shqiptarëve, kongresmeni i njohur **Hon. Eliot Engel**, nuk arriti të rizgjidhej në primaret e Partisë Demokratike Amerikane. Ai largohet nga Kongresi pas dy vitesh në detyrën e lartë si **Kryetar i Komisionit për Marrëdhënie me Jashtë**.

1. **Engel largohet duke lënë pas një trashëgimi të pashembullt në politikën amerikane**. Për ne shqiptarët, ai mbetet një mik i rrallë dhe i shtrenjtë — ndoshta i pazëvendësueshëm për një kohë të gjatë.

Në nderim të kontributit të tij të jashtëzakonshëm për çështjen shqiptare, i kushtova këtë shkrim me respektin më të thellë.

Miq të mëdhenj të Shqipërisë

Historia e shqiptarëve në Ballkan është e mbushur me ngjarje të shumta – tragjedi, humbje dhe fitore. Megjithatë, duhet theksuar se në këtë udhëtim të vështirë të kombit tonë, kemi qenë me fat: gjithmonë kemi pasur

përkrahës të huaj që na janë gjendur pranë në momentet më kritike.
Kur kthejmë kokën pas, na vijnë ndër mend emra të njohur të personaliteteve të huaja që na kanë parë me simpati, kanë shkruar për ne, kanë kontribuar në zgjidhjen e çështjes sonë kombëtare – e madje disa prej tyre kanë sakrifikuar jetën për të.
Lordi Bajron e bëri të njohur në mbarë botën anglo-saksone trimërinë shqiptare në veprën e tij aq të dashur, *"Udhëtimi i Child Haroldit"*.
Himnizimi i virtyteve shqiptare prej tij, në atë kohë, u bë burim frymëzimi për rilindjen kombëtare shqiptare.

Benjamin Disraeli, me veprën *"Naltësimi i Iskanderit"*, iu referua heroit tonë kombëtar **Gjergj Kastriot Skënderbeut**, duke e bërë të njohur vendin tonë në një kohë jashtëzakonisht të vështirë.
Veprat e *"Mbretëreshës së Malësorëve"*, **Edith Durham**, ngritën në këmbë fuqitë e mëdha dhe i mësuan botës se kush janë shqiptarët dhe çfarë përfaqësojnë ata në Ballkan.
Një tjetër figurë e ndritur ishte **Milan Šufflay**, një hebre kroat, i cili ia kushtoi jetën studimeve mbi shqiptarët dhe e pagoi këtë me jetën e tij, si pasojë e kundërshtimit të ashpër serb ndaj së vërtetës që ai përfaqësonte.

Reverendi Charles Telford Erickson i kushtoi jetën dhe familjen Shqipërisë, duke luajtur një rol vendimtar në bindjen e **Presidentit Woodrow Wilson** për të mbrojtur ekzistencën e Shqipërisë si shtet. Ishte pikërisht **Presidenti Wilson** që e mbrojti të drejtën e Shqipërisë për ekzistencë në **Konferencën e Paqes në Paris**, më 1919.
Politikani anglez, **koloneli Aubrey Herbert**, së bashku me **Lordin Robert Cecil**, lobuan me vendosmëri për njohjen e **Pavarësisë së Shqipërisë** dhe për anëtarësimin e saj në **Lidhën e Kombeve**.
Amerikano-hebreu Herman Bernstein u dashurua me popullin shqiptar dhe me Mbretërinë shqiptare të viteve ’30, duke shërbyer me përkushtim si ambasador i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë.
Kjo listë do të ishte shumë më e gjatë po ta vazhdoja, por ajo më çon pashmangshmërisht te një emër që meriton të shkruhet me gërma të arta në altarin e miqve më të mëdhenj të kombit tonë – si tribuni i lirisë për gjysmën tjetër të popullit shqiptar: atë në Kosovë.

Është kongresmeni amerikan Eliot Engel.

Karriera e tij e gjatë politike është e lidhur, prej afro tri dekadash, me çështjen shqiptare. Që nga ajo ditë kur në derën e zyrës së tij trokiti një djalë simpatik nga Kosova, rreth

të tridhjetave, me emrin **Harry Bajraktari**, jeta e kongresmenit Engel u lidh ngushtë me çështjen e **Kosovës** dhe të shqiptarëve në përgjithësi.
Atë ditë, **Harry** i rrëfeu kongresmenit për tragjedinë e popullit të vet – për luftërat, përpjekjet, mundimet, dëbimet, vrasjet, ekzekutimet, përpjekjet për shfarosje, përndjekjet, margjinalizimin, aparteidin... madje edhe për një formë të heshtur **holokausti** që po ushtrohej ndaj shqiptarëve në **ish-Jugosllavi**.

Ai i foli për Besën Shqiptare dhe për mbrojtjen që shqiptarët u kishin ofruar hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore – një akt humanizmi që tani, në mënyrë tragjike, po e përjetonin vetë shqiptarët.
Ai takim kishte peshën e një ngjarjeje historike, që do të lidhej drejtpërdrejt me zgjidhjen e fatit të një populli të tërë. **Harry Bajraktari** po i shpjegonte dramën e popullit të vet një njeriu që dëgjonte me vëmendje të jashtëzakonshme – një biri të një familjeje hebraike që kishte përjetuar vetë dhimbjen, persekutimin dhe shfarosjen.

Që prej asaj dite, lidhja midis **Harry Bajraktarit** dhe kongresmenit **Eliot Engel** u shndërrua në një marrëdhënie me ndikim të jashtëzakonshëm mbi fatin e popullit të **Kosovës**.

Eliot Engel, me durimin dhe qetësinë që e karakterizonte, dhe i mbështetur nga shumë senatorë e kongresmenë të tjerë – miq të mëdhenj të shqiptarëve si **Robert Dole**, **Alfonse D'Amato**, **Tom Lantos**, **Benjamin Gilman**, **John McCain** e shumë të tjerë – arriti të vendoste **çështjen e Kosovës** në zemër të **agjendës së politikës së jashtme amerikane**.

Ndarja me vijë të kuqe, që **Presidenti George H. W. Bush**

i bëri kufirit të Kosovës me Serbinë në vitin 1992, do të kërkonte domosdoshmërisht angazhimin dhe ndihmën e **Kongresmenit Engel**, për t'u zbatuar disa vjet më vonë nga **Presidenti Bill Clinton**.

Dhe kjo ndihmë erdhi gjithnjë në rritje, falë ndërgjegjes së lartë humane të **Kongresmenit Engel**, si dhe njohjes së thellë që ai i përcolli **Presidentit Clinton** dhe administratës së tij mbi këtë çështje jetike.
Sa më shumë shtohej shtypja dhe persekutimi nga **satrapi Millosheviç** ndaj shqiptarëve, aq më shumë intensifikohej puna e **miqve të shqiptarëve në Uashington** për t'i dhënë fund kësaj tragjedie – që po godiste një popull të pafajshëm dhe po turpëronte ndërkohë gjithë botën e civilizuar.

Në këtë dualitet të madh të historisë dhe politikës ndërkombëtare, **veprimtaria e Kongresmenit Engel ishte qenësore**, pasi ai qëndroi në ballë të të gjitha përpjekjeve për mbështetjen e çështjes shqiptare.
Falë këtij angazhimi të pandërprerë dhe solidaritetit të miqve të tjerë të shqiptarëve në Uashington, u arrit deri te ndërhyrja ushtarake e NATO-s, që solli çlirimin dhe më pas shpalljen e pavarësisë së Kosovës.
Edhe pse përfaqësues i **Partisë Demokratike**, **Kongresmeni Engel** iu bashkua me bindje **republikanëve**, në mbështetje të **Presidentit George W. Bush**, për **njohjen zyrtare të Pavarësisë së Republikës së Kosovës**.

Nga ana tjetër, **Kongresmeni Engel** mbante gjithnjë një sy edhe mbi zhvillimet në **Shqipëri**, duke i ndjekur me vëmendje dhe interes të veçantë. Për këtë arsye, ai u bë një ndër figurat më të dashura dhe më të respektuara për shqiptarët, kudo që jetojnë.
Falë z. Harry Bajraktari, kam pasur nderin, privilegjin dhe kënaqësinë të takohem shumë herë me Kongresmenin Engel.
Përherë kam dëgjuar prej tij fjalën e urtë të një burri të matur, të pajisur me ndjeshmëri të thellë për çështjet shqiptare dhe me shqetësimin e sinqertë për mbarëvajtjen e punëve në **Ballkan**.

Ai flet me simpati të sinqertë për shqiptarët dhe ka deklaruar hapur se ishte **takimi me Harry Bajraktarin** ai që e nxiti të angazhohej me çështjen shqiptare.
"Kur mësova për historinë e popullit tuaj, dhe më pas për vlerat tuaja familjare, për traditën, besën, mikpritjen, respektin ndaj të moshuarve, bujarinë, mëshirën dhe dhimbjen për të vuajturit – gjeta në to shumë ngjashmëri me ato të racës prej nga vij unë. Atëherë ndjeva një thirrje të brendshme për të kontribuar për këtë çështje."
Këto fjalë të Kongresmenit **Eliot Engel** janë pasqyrë e shpirtit të tij human dhe dëshmi e miqësisë së palëkundur që ai ndërtoi me shqiptarët, duke u bërë një zë i tyre në arenën ndërkombëtare.

Sa herë takohem me Kongresmenin Engel, ndjej se marr me vete një pasuri të madhe shprese dhe besimi tek e ardhmja e vendit dhe kombit tonë.
Më ka rastisur që, gjatë një darke me të në Washington, ai të thirrej në telefon nga **Presidenti i Shteteve të Bashkuara** dhe të qëndronte thuajse një orë në bisedë me të për çështje të rëndësishme të **politikës së jashtme amerikane**.
Pasi u kthye në tavolinë, **me atë modestinë e rrallë që e karakterizon**, ai e vazhdoi bisedën aty ku e kishte lënë – sikur të mos kishte ndodhur asgjë, edhe pse sapo kishte

komunikuar me njeriun më të fuqishëm të globit:
Presidentin amerikan Barack Obama.

Në shtator të vitit 2016, **Kongresmeni Eliot Engel** dhe miku i tij i ngushtë, **Harry Bajraktari**, u shpallën **"Qytetarë Nderi" të Lezhës**. Ishte një ditë e bukur, domethënëse, jo vetëm për ta, por edhe për vetë qytetin që i nderoi.
Fjalimi i kongresmenit, i mbajtur brenda në **Memorialin e Heroit Kombëtar, Gjergj Kastrioti Skënderbeu**, ishte një thirrje e fuqishme për **bashkimin e shqiptarëve** – ashtu si dikur, kur u mblodhën nën udhëheqjen e Gjergjit tonë të madh.
Një njeri aq i rëndësishëm si Kongresmeni Engel reflektonte një modesti dhe thjeshtësi të tillë, saqë ndiheshe sikur ishe pranë një miku me të cilin ndaje vlera dhe përjetime shpirtërore të përbashkëta.
Në një mbrëmje të organizuar nga **Shoqata e Grave Shqiptare "Motrat Qiriazi"** në **New York**, në **tetor të vitit 2018**, zonja e tij, **Pat Engel**, bëri një deklaratë publike që emocionoi të gjithë të pranishmit:
"Unë jam shqiptare."
Një fjali e shkurtër, por me peshën e një miqësie të sinqertë dhe një përkushtimi të rrallë që tejkalonte përkatësinë formale – një përqafim i vërtetë shpirtëror ndaj kombit tonë.

Zonja Pat Engel, pasi foli me dashuri për **shqiptarët**, **Kosovën**, **Harry Bajraktarin** dhe rrethin e tij të afërt familjar, përfshirë edhe **z. Rrustem Geci**, iu kthye fillimit të fjalës së saj dhe shtoi:
"Po jua kujtoj edhe një herë: Eliot dhe unë ndjehemi shqiptarë, sepse prej jush – shqiptarëve – kemi mësuar shumë, kemi marrë aq shumë dashuri, frymëzim dhe kemi parë aq shumë vlera të rralla njerëzore."
Ishte një moment prekës, që thelloi edhe më tej ndjenjën e respektit dhe mirënjohjes së ndërsjellë, duke e bërë të qartë se miqësia e familjes Engel me shqiptarët është e sinqertë, e thellë dhe e qëndrueshme.

Më **30 prill 2019**, pata rastin të ndjek një **seancë dëgjimore në Komisionin për Marrëdhëniet me Jashtë të Kongresit Amerikan**, të drejtuar nga **Kongresmeni Eliot Engel**, tashmë në postin e **Kryetarit të këtij Komisioni**.
Seanca ishte e përkushtuar ndaj një teme tejet të ndjeshme: **dhuna seksuale e ushtruar ndaj grave në Kosovë** nga falangat serbe të regjimit të **Sllobodan Millosheviçit**.
Në **verën e vitit 2019**, në shenjë mirënjohjeje të thellë, **autoritetet lokale të Tropojës dhe Gjakovës** vendosën që **rruga që nis në Fierzë dhe përfundon në Ponashec** të mbajë emrin e **Kongresmenit Eliot Engel**.

Ajo rrugë, në të vërtetë, simbolizon kontributin e Kongresmenit Engel në të dy anët e kufirit shqiptaro–shqiptar.
Serioziteti me të cilin ai, pas njëzet vitesh, riktheu vëmendjen e politikës amerikane tek çështja e Kosovës, të bënte të reflektoje dhe të bindeshe se kishim përballë një mik të vërtetë, një zë të palëkundur në mbrojtje të së drejtës sonë, dhe sa me fat kemi qenë që e patëm atë në krah në momentet më vendimtare.
Faleminderit, i nderuar Kongresmen Engel!
Mirënjohja jonë është e përjetshme.

BASHKIA TROPOJË
Welcome Congressman
Eliot L. Engel

Eliot ENGEL